



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Drejtoria e Inspekcioneve
Drenas , më 07.11.2018



RAPORT PËR MUAJIN TETOR 2018

Gjatë këtij muaji me rëndësi të veçantë janë realizuar kontrollat në transportin publik sipas planit të ri operativ, kryesisht largimi i taksive ilegale duke marrë të gjitha masat e nevojshme sipas Ligjit të Transportit Rrugor.

Në vazhdim po ju sjell punët e kryera nga secili Inspektor sipas sektorëve të tyre përkatëse:

Spektori i Ndërtimit gjatë këtij muaji janë inspektuar ndërtimet në Drenas, në veçanti ndërtimet pa leje në zonat e urbanizuara në afërsi të rrugëve regjionale dhe lokale, në zonën e tokës bujqësore nën masën e komosacionit dhe ndërtimet që bëhen në pronën komunale. Gjatë zhvillimit të procedurave, janë hartuar edhe urdhëresat për ekzekutime, njoftime dhe përgjigje ndaj kërkesave. Është përcjellur rënimi i hyrjes nga bllokat e silkaporit në një banesë në Bllokun V në Drenas.

Spektori i Komunikacionit këtë muaj është filluar me kontrollat të transportit rrugor dhe largimin e transportuesve ilegal sipas planit të ri operativ, e gjithashtu kontrollat të rendit të udhëtimit të kompanive transportuese të licencuara. Gjatë këtij muaji është vazhduar me masat e radhës gjatë hasjes në transportues ilegal ku janë shqiptuar 6 gjoba mandatore në vlerë prej 100 € (njëqind euro) si dhe 1 gjobë në vlerë prej 100€ (njëqind euro) për kompanitë transportuese të licencuara që kanë bërë shkelje të ligjit gjatë transportit. Gjithashtu janë bërë 7 konfiskime të automjeteve në kohëzgjatje prej 5 ditë të transportuesve ilegal.

Spektori i Sanitarisë: gjatë këtij muaji është filluar me kontrollën e subjekteve afariste hoteliere rreth respektimit të Ligjit të duhanit, ku në përgjithësi është konstatuar se shumica prej lokaleve kanë filluar me marrjen e masave të para për mbikëqyerjen e këtij ligji. Gjatë këtij muaji janë lëshuar 4 aktvendime për pëlqim të kushteve të përgjithshme sanitare të ordinancave shëndetsore private.

Spektori i Tregut: është vazhduar me kontrollën e tregut javor dhe me largimin e tregtarëve që shesin jashtë lokacionit të tregut në rr.Fehmi dhe Xhevë Lladrovci në ditën e tregut, gjithashtu janë inspektuar bizneset (autolarjet) për kontrollë të dokumentacionit të biznesit.

Spektori i Ambientit ka vazhduar me kontrollën e bizneseve dhe urdhëresat për të hyrë në sistem të menaxhimit të mbeturinave, gjithashtu ka shqyrtuar 3 kërkesa rreth ambientit. Gjatë muajit tetor janë bërë inspektime të 6 pronave ku është hedhur material inert sipas kërkesës nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, në të cilat raste pronarët janë urdhëruar për rrafshimin (nivelizimin) e këtij materiali. Po ashtu janë kontrolluar kohë pas kohe pronat publike në Gllanasellë, Likoshan, Kishnarekë, Nekoc dhe Llapushnik rreth shfrytëzimit të materialit guror dhe nuk është hasur në persona pranë këtyre vendeve.

Ka pasur kërkesa për pëlqim në ushtrimin e veprimtarisë dhe kërkesa për leje mjedisore (ku janë shqyrtuar 5 kërkesa për LMK nga Komisioni).

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punës në shifra për muajin Tetor 2018:

Sektori	Procesverbale	Aktvendime	Urdhër ekzekutimi	Gjoha mandatore	Kërkesa për Pëlqim sanitar	Pëlqime Sanitare	Kërkesa	Shqyrtim i kërkk.	Konfiskim i targave dhe automjeteve
Sanitar	23	4			4	4			
Tregu	12	2					3	3	
Komunikacioni	23			7					7 A
Ndërtimi	23		2				6	6	
Ambienti	18						3	3	
Totali	99	6	2	7	4	4	12	12	7

Nëntor 2018